# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443604**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Begaj vizitë në Arabi: Forcimi i marrdhënieve ekonomike në interes të dy vendeve – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/begaj-vizite-ne-arabi-forcimi-i-marrdhenieve-ekonomike-ne-interes-te-dy-vendeve/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 15:23:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 15:21:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `552ef908a7d2983e84e1e4ad577edd028d8afc2ec39b2c3731ab98700d193902` |
| TEKSTI | `ee0a22bc45dd6474756bd9ff0f92a961da7551ebd0ddf67a52b4439566a74d6a` |
| PAMJA | `1798253b2e0f895840d012bb041ce153c8e858219aaa2a5602e6399f70ed56b1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1c6fc3458555bbae308480bd6a9d9f5ac4d4fc437ceceecba5e9e41253d0dce9` |
| E MËPARSHMJA | `25ea1ab9326f3e1c9703efe5ab4d154887389d8600b85e34342f3205d4da3824` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1c6fc3458555bbae308480bd6a9d9f5ac4d4fc437ceceecba5e9e41253d0dce9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kjo ishte vizita e parë e një Presidenti të Republikës së Shqipërisë në Emiratet e Bashkuara Arabe, e cila rikonfirmoi angazhimin e dy vendeve për forcimin e mëtejshëm të partneritetit Shqipëri–EBA, të orientuar drejt së ardhmes.

Presidenti i Republikës u prit nga Presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Lartësia e Tij Sheikh Mohamed bin Zayed Al Nahyan.

Gjatë takimit, Presidenti Begaj falënderoi Emiratet e Bashkuara Arabe për solidaritetin dhe miqësinë e treguar ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve në momente të vështira, veçanërisht gjatë luftës në Kosovë, pas tërmetit të vitit 2019 dhe pas sulmit kibernetik të vitit 2022.

Në takim u shpreh vullneti i përbashkët për të avancuar më tej axhendën e bashkëpunimit të fortë dhe të qëndrueshëm ndërmjet dy vendeve, si dhe për të shfrytëzuar potencialet reale për zgjerimin e tij në fusha me interes të ndërsjellë.

Presidenti Begaj theksoi se lidhjet politike, ekonomike dhe njerëzore ndërmjet Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe do të forcohen më tej, veçanërisht me hapjen e Ambasadës së Emirateve të Bashkuara Arabe në Tiranë.

Bashkëpunimi ekonomik dhe investimet përbënin një nga shtyllat kryesore të diskutimeve. Duke vlerësuar forcimin e këtij partneriteti, Presidenti Begaj u shpreh për zgjerimin e investimeve dypalëshe dhe për një angazhim edhe më të madh të investitorëve emiratas në Shqipëri, veçanërisht në infrastrukturë, energji, inovacion, turizëm dhe sektorë të


5 Kishte dalë nga burgu me leje dhe duhej të kthehej sot, Alket Rizai...



NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

veçanërisht në infrastrukturë, energji, inovacion, turizëm dhe sektorë të tjerë strategjikë.

Presidentët e dy vendeve diskutuan gjithashtu për bashkëpunimin shumëpalësh dhe sfidat ndërkombëtare, ku Shqipëria dhe Emiratet e Bashkuara Arabe ndajnë prioritete të përbashkëta për paqen, sigurinë dhe zhvillimin.

Në shenjë të mirënjohjes së shtetit shqiptar për kontributin e tij në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, Presidenti i Republikës i dorëzoi Lartësisë së Tij, Sheikh Mohamed bin Zayed Al Nahyan, dekoratën "Urdhri Suprem i Shqiponjës".

Gjatë vizitës në Emiratet e Bashkuara Arabe, Presidenti Begaj zhvilloi gjithashtu takime me Lartësinë e Tij Sheikh Khaled bin Mohamed bin Zayed Al Nahyan, Princ i Kurorës së Abu Dhabit, si dhe me Lartësinë e Tij Sheikh Mansour bin Zayed Al Nahyan, Zëvendëspresident i Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Kryetar i Gjykatës Presidenciale.

#Arabi #BEgaj #Ekonomike #marrdheniet #VizionPlus

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**"B40" në krah të Erion Veliajt: Paraburgimi,...**

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë



POLITIKË

**Ilir Meta del nga kafazi, kreu i PL-së d...**

Xhuljana Zhuleku · 4 orë më parë



POLITIKË

**PD: Hetim parlamentar për...**

Xhuljana Zhuleku · 4 orë më parë

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.